

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“DIAMOND PRODUCTION COMPANY” SH.P.K.

Sot, më date **22.03.2023**, une i nënshkruari:

-Redion Daka lindur me 11/02/1999, ne Lushnje dhe me residence ne Divjake, shtetas Shqiptar i identifikuar nepermjet leternjoftimit me nr.**033482698** , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar....; në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” kam vendosur të themeloje një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar **“DIAMOND PRODUCTION COMPANY” SH.P.K.** (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

Neni 1

Emri i Shoqërisë është: **“DIAMOND PRODUCTION COMPANY” SH.P.K.**

Neni 2

(1)Selia e shoqërisë ndodhet në adresën Fier Divjake Ndertese ne katin perdhe ,Lagja Nr 2 ,Rruga 20 Janari ,Nr pasurie 492/67 ,Zone Kadastrale Nr 1492 .

(2)Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: *sligerdaka12@gmail.com*
Shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

Neni 3

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 10 vjet dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Biznesit.



Neni 4

Objekti

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :

a) Aktivitet në fushën e prodhimit të konfeksioneve veshjeve të të gjitha llojeve duke punuar për vetë ose me porosi për llogari të të tjerëve. Tregtimin e konfeksioneve, veshjeve brenda dhe jashtë Shqipërisë, të importojë dhe të tregtojë stoffa dhe lenda të para ndihmese makineri dhe pajisje prodhimi, tregti me shumicë e pakicë, tregti me shumicë e pakicë, import-Eksport të të gjitha llojeve të konfeksioneve të veshjeve, prodhimin e kepuceve të etiketuara në markën e vetë ose të të tjerëve, qepje të ndryshme për vetë dhe të të tjerët, Regjimi i përpunimit aktiv-Megjithëatë shoqëria ka të drejtë që të shtojë dhe të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj me vendim të asambleës së ortakëve .

-Megjithëatë shoqëria ka të drejtë që të shtojë dhe të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj me vendim të asambleës së ortakëve.

Neni 5

Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100 000** (një qind mijë) Lekë

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Z. Redion Daka** : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **100 000** (një qind mijë) Leke që përbën **100 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve do të jetë në para.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themeltar mund të bëhet vetëm pasi Asambleja e ortakëve me shumicë e ka dekretuar këtë dhe për më tepër të gjithë ortakët janë të detyruar që ta repektojnë dhe të kontribuojnë në para ose në natyrë në bazë të vendimit të shumicës së asambleës

Neni 7:

Transferimi i kapitalit



Kuotat e kapitalit te një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen pëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërise
- b) shitblerjes;(me te drejten e parablerjes nga ana e ortakëve).
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të trasferueshme ndërmjet ortakëve,përsa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltare janë ligjerisht të trasferueshme me rrugë trashgimnie.

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakëve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë.Asambleja e Ortakëve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve ,përfjashtimi nga e drejta e votës dhe te tjera modalitete per funksionimin e organit vendimmarres percaktohen ne statutin e shoqërise.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqërise emerohet z. **Redion Daka** lindur me 11/02/1999, ne Lushnje dhe me rezidence ne Lushnje, shtetas Shqiptar i identifikuar nepermjet leternjoftimit nr.**033482698**, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i zgjedhur per nje periudhe **5** vjecare me te drejte rizgjedhje.

Kompetencat dhe përgjegjësitet e Administratorit jane te percaktuara qarte ne statutin e shoqërise.

Neni 10

Viti financiar-ekspertët



Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përgjatimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxierien e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që tja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 11

Prishja-riorganizimi i shoqërisë

Modalitetet për prishjen dhe riorganizimin e shoqërisë janë të percaktuara në statutin e shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 12

Akti i Themelimit është hartuar në 4 kopje origjinale.

ORTAKU I VETEM I SHOQËRISE

Redion Daka

Redion DAKA
RD